



**Departamenti i Matematikës
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës**

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
në Mësuesi "Matematikë-Informatikë"
I Institucionit të Arsimit të Lartë "Aleksandër Moisiu"**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Doc. Neime Gjikaj
2. Dr. Orges Beqiri
3. Dr. Teuta Thanasi
4. Spiro Paco
5. Oriola Domi
6. Asilda Cotaj

Mars /2023

 A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Information" followed by initials "B" and a surname.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES VLERËSIMI TË BRENDSHËM

Përshkrim përbledhës; 200 fjalë

Prej viti akademik 2018 –2019 Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës u ofron studentëve të Ciklit të Dytë një program të ri në FTI, programin MSH në Mësuesi në “Matematikë-Informatikë”, me 120 ETCS.¹ Ky program studimesh synon përgatitjen e mësuesve të Matematikës dhe Informatikës, për AMU, AML, mbështetur në teknikat më të mira në mësimdhënie. Qëllimi i këtij programi studimi është të ofrojë përgatitjen profesionale të mësuesve të arsimit parauniversitar për lëndën e matematikës dhe informatikës, të mundësojë një karrierë të mëtejshme profesionale në institucionet e Arsimit Parauniversitar.

Për këtë program studimi konstatohet përputhje e kënaqshme e objektivave të programit me kompetencat bazë, të cilat duhet të fitojnë studentët në përfundim të MSH. Programet e kurseve të përfshira në kurrikul ofrojnë njohuritë e duhura teorike dhe aftësimin e duhur profesional, ku roli i mësuesit të matematikës e Informatikës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar mbështet plotësisht fitimin e aftësive e kompetencave të zotërimit të tre tipologji kompetencash: pedagogjiko-projektuese për krijimin e mjetësive të integruara në procesin e mësimdhënie –nxënies, metodologjike-didaktike dhe gjuhësore-shprehëse për të prodhuar materiale në fushën e caktuar të dijes.

Niveli i dijeve të ofruara në programin e lëndëve është plotësisht i përshtatshëm për nivelin e ciklit të Dytë të studimeve.

¹ Vendimi I hapjes



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM


200 FJALË

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave në mësuesi (MSc.)" në "Matematikë-Informatikë" është përgatitur nga grupi i ekspertëve të vlerësimit të brendshëm (GVB), i ngritur me vendim Nr. 01 dt. 20.01.2023 të Dekanit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR, ASCAL dhe Statutin e UAMD -së. Përbërja e GVB është përcaktuar mbi bazën e disa kritereve që lidhen me aftësitë dhe kompetencat profesionale të tyre në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, në integritetin dhe aftësitë e tyre për një analizë dhe vlerësim të paanshëm të dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm për kryerjen e procesit të akreditimit. Në përbërjen e grüpuit është i përfshirë edhe një student.


GVB për realizimin e procesit të vlerësimit të këtij programi studimi është bazuar në kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, udhëzimet dhe manuale të ASCAL-it, Statutin dhe Vendimet e Senatit Akademik të UAMD-së.

GVB në marrjen e informacionit, përpunimin e tij dhe hartimin e RVB, ka operuar duke ndarë në mënyrë të quartë detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të tij me qëllim arritjen e përfundimeve sa më të drejta e reale në funksion të vlerësimit të cilësisë të këtij programi studimi. GVB ka grumbulluar, shfrytëzuar dhe analizuar të gjitha të dhënat dhe informacionin e brendshëm në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti, të nevojshme për procesin e vlerësimit të programit të studimit, të cilat janë përfshirë në mënyrë të strukturuar në RVB dhe gjenden në dosjen e Anekseve të vlerësimit të brendshëm ku janë listuar të gjitha dokumentat bazë të kërkua e përprocesuar e akreditimit të programit të studimit. RVB, i cili përbën edhe dokumentin kryesor të procesit të akreditimit është plotësuar sipas modelit të hartuar nga ASCAL në përputhje me kërkesat ligjore për sigurimin e cilësisë në IAL-të. RVB përmban gjashtë fusha vlerësimi të detajuara me standartet dhe kriteret përkatëse, mbi bazën e të cilave, referuar dokumentacionit të kërkuar, vlerësohet shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit.

Në pjesën e fundit të RVB jepen përfundime të vlerësimit të programit të studimit "Master Shkencor në Mësuesi" në "Matematikë-Informatikë".



~~Information~~

Dr. John Doe

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Mësuesi në “ Matematikë- Informatikë ”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij

(Ligji 80/2015: Neni 1, Pika b, c, d)

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. L. 80/2015: Neni 1, Shkr d L. 80/2015: Neni 5, Pika 2, ç.</p> | <p>Po. UAMD harton programe studimi që janë në shërbim të interesave kombëtare në shërbim të kombit dhe të shtetit, duke u bazuar në Kreun 1, pika 1 për ligjin e Arsimit të Lartë, 2015. UAMD është i përkushtuar ndaj idealeve të qasjes, angazhimit, udhëheqjes, dhe të shërbimit të cilat sjellin përfitime praktike në fushën e arsimit të shtetit, kombit dhe komunititetit global duke u bazuar në pikën “Vlerat” në Planin strategjik të UAMD. Synimi mbetet një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që ofron mundësi të barabarta për të gjithë, duke respektuar, njëherazi, dallimet vetjake. që ofrohen nga institucioni respektojnë interesat kombëtare, gjë e cila shprehet në misionin dhe qëllimin e tij. Këtë e përcaktojnë edhe dokumentet bazë të vetëqeverisjes së tij si Statuti i UAMD², Plani strategjik i UAMD, 2020-2025³ dhe Rregullorja e Programit të Studimeve Universitare⁴. Gjithashtu, këto programe sigurojnë qëndrueshmëri në përgatitjen e mësuesve të Matematikës dhe Informatikës, fushë me interes kombëtar. Programi mësimor⁵ pasqyron mbështetjen e vlerave dhe interesave kombëtare dhe nxit ruajtjen dhe pasurimin e tyre.</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimitarës.</p> | <p>Po. Misioni i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit si një njësi shumë e rëndësishme e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës është që në mënyrë të vazhdueshme, të arrijë standartet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilit do që të përfitojë nga arsimi i lartë. Vetë Universiteti, dhe Fakulteti si njësi e tij, ka në qëllimin e tij nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analistik, ruajtjes së të dhënave personale si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunititetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin, mbështetur në qëllimin e vetë UAMD-së dhe qëllimin e programit të studimit MSH/MI, e shprehur kjo edhe nga Mendimi i Dekanes⁶. Duke qenë në koherencë me misionin e UAMD, programi i studimit në misionin e tij pasqyruat në Planin Strategjik të MSH/MI⁷ synon në mënyrë të vazhdueshme arritjen e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Qëllimi i programit të</p> |

² Statuti i UAMD-së, Kreu II, neni 2, pika 1 deri 7; Kreu VII.

³ Plani strategjik UAMD

⁴ Rregullore e studimeve Universitare, Kreu I, neni 1 dhe 2, Kreu V, neni 34 dhe 35

⁵ Programi mesimor -

⁶ Mendimi i Dekanes

⁷ Plani Strategjik



| | <p>studimit është "Studenti në Qendër", të cilësuara edhe në Strategjinë e zhvillimit të Institucionit⁸. UAMD, në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimin e tij, ofron një numër të madh programesh studimi në fusha të ndryshme të veprimitarisë së tij.</p> <p>Programi i studimit "Master Shkencor" në Mësuesi në "Matematikë-Informatikë" plotëson kriteret në hartimin e tij dhe ofrohet në përputhje qëllimet dhe misionin e UAMD-së, si dhe fushën e veprimitarisë se tij⁹. Ky program studimi synon në përgatitjen e mësuesve të matematikës dhe informatikës sipas kompetencave profesionale në përputhje me zhvillimet e sotme shkollorë dhe prespektiven e mësimdhënies si dhe të jenë te aftë për të kontribuar në formimin e zhvillimin e qëndrueshmërit të mësuesve në Shqipëri.</p> | | | | | | | | |
|--|---|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 3. Programi i studimit hartohej dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit. | Po Programi i studimit Master Shkencor në Mësuesi në "Matematikë-Informatikë" është hartuar në përputhje me strategjinë ¹⁰ e UAMD-së. Institucioni thkson rëndësinë e rr jitës cilësore të programit të studimit në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit sipas pikave 1 dhe 8 te <i>misioni</i> strategik i Planit Strategjik të UAMD. Statuti ¹¹ dhe Rregullorja e institucionit ¹² përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij mbështetur në <i>misionin, qëllimin</i> të përcaktuara në nenin 3 dhe 4 të Statutit të UAMD dhe neni 1 i Rregullores së UAMD. Drejtimet prioritare akademike të programit të studimit gjenden në nenet 59, 63 të Statutit të UAMD dhe në nenet 41, 45 të Rregullores së UAMD, të cilat përputhen me drejtimet e institucionit si më lart. | | | | | | | | |
| Kriteri 4. Programi i studimit hartohej e zhvillohet në përputhje me strategjitet kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Po. Programi i studimit Master Shkencor në Mësuesi në "Matematikë-Informatikë" hartohej dhe zhvillohet në përputhje me <i>misionin</i> e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit ¹³ e cila është në përputhje me <i>vizionin</i> e Planit strategjik ¹⁴ të Departamentit të Matematikës dhe <i>vizionin</i> e Planit strategjik të MSH/MI (<i>vizioni</i>) ¹⁵ . Programi i studimit është i projektuar për individë të interesuar në përfitimin e njojurive profesionale të specializuara në fushën e edukimit, Matematikë dhe Informatikë. Programi u mundëson studentëve përvetësimin dhe aplikimin e njojurive të avancuara mbi matematikën dhe informatikën, për ndërtimin e karrierës së tyre në institucionet arsimore duke investuar në kapitalin njerëzor i cili do jetë një vlerë e shtuar nëpërmjet shtimit të konkurrueshmërisë dhe novacioneve; | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotesisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotesisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotesisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion

| Kriteret | Vlerësimi |
|----------|-----------|
|----------|-----------|

⁸ Strategjia e UAMD

⁹ Rregullore e programit te studimit

¹⁰ Strategjia e UAMD

¹¹ Statuti i UAMD

¹² Rregullorja e UAMD

¹³ STRATEGJIA KOMBËTARE E ARSIMIT 2021-2026

¹⁴ Plani strategjik i DM

¹⁵ Plani strategjik UAMD

| | | | | |
|---|--|--|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. L. 80/2015: Neni 25, Pika 4, 7. | Po Fakulteti i TI si pjesë e Universitetit "Aleksandër Moisiu" zbaton Statutin e Universitetit, Kreu II, i cili është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përshtatje me misionin dhe objektivat e tij. Programi studimit MSH/MI është hapur me Vendim ¹⁶ Nr. 39 Datë 16.05.2018 te Senatit Akademik te UAMD me urdher ¹⁷ NR 656, Date 11.10.2018 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Matematikës, i cili përbëhet përkatësisht nga 15 anëtarë të kualifikuar ndër vite, ku 4 prej tyre zoterojnë titullin Profesor i Asociuar, 6 janë me graden Doktor i Shkencave 1 Docent dhe gjëzojnë kompetencë e kontributë të fushën e Matematikës pasqyruar në CV-të dhe në Dosjet e vëtyvlerësimit dhe ofron një program studimi të shpërndarë në dy cikle studimi. Gjithashtu programi i studimit mbulohet edhe nga personeli akademik i departamenteve të tjera të Fakultetit të TI, i cili ka në përbërjen e tij departamentet, Departamenti i Matematikës, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Të gjithë këto departamente ndihmojnë në përbushjen e qëllimeve akademike që ka programi i studimit MSH/MI | | | |
| Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Po. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane nën emërtimin UAMD-MPS-70412-BAFI. Programi ofron leksione në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me mësimdhënien si dhe teknologjinë dhe programimin duke i plotësuar gjithashtu dhe me njohuritë e fjalës më të fundit në këto fusha | | | |
| Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitat bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Po. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit (në rastin tonë nuk është program ndërdisiplinor) është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore . Ai vjen si vazhdim i programit të studimit Bachelor në "Matematikë-Informatikë", Bachelor në "Informatikë-Anglisi", "Shkenca kompjuterike", Bachelor në "Teknologji Informacioni", Bachelor në "Sistemë Informacioni", etj | | | |
| Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtëm specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | UAMD ofron trajnime të akredituara në fushat përkatëse përfshire edhe mësuesinë dhe integrimin e teknologjisë në mësimdhënie. Një numër studentësh të sapodiplomuar kanë marrë kredite të vlefshme nga UAMD ¹⁸ | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet <input type="checkbox"/> | Përbushet pjesërisht <input type="checkbox"/> | Përbushet kryesisht <input checked="" type="checkbox"/> | Përbushet plotesisht <input checked="" type="checkbox"/> |

Standardi I.3

¹⁶ Vendim i Senatit Akademik nr 39

¹⁷ Urdheri i MASR nr 656

¹⁸ Lista e moduleve të akredituara nga QEV.

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhëniet bashkëpunimi me institucionet, kompanit, palët e treta, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit

(Ligji 80/2015: Neni 3, Pika4 Shkr c).

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhëniet të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | <p>Po. Ligji për Arsimin e lartë, 2015, nen 57 dhe 58; nen 51 i Statutit UAMD; nen 24 i Rregullores së FTI, përcaktojnë detyrat e personelit dhe statusin e tyre. Gjithashtu, mbështetur në nenin 11, pika f, detyrat dhe përgjegjësi të tjera respektive janë të përcaktuara në marrëveshjet e firmosura¹⁹ midis drejtuesit të departamentit dhe anëtarëve të departamentit, në cdo fillim viti. Institucioni siguron gjithmonë bashkëpunime mes njësive të personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Duke u bazuar në Rregulloren e Cilësisë së NJSBC²⁰, janë caktuar detyrat e kordinatorëve të programit të studimit apo personelit nëpërmjet marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Gjithashtu Departamenti ngre grupe pune për çështje të ndryshme administrative, si "Ngritje komisioni për procedurën e pranimeve, transferimeve dhe aplikimeve për programin e dytë të studimit, Master Shkencor, në Mësuesi në "Matematikë-Informatikë"; "Propozim për ngritje komisioni për procedurën e vlerësimit dhe rekrutimit të stafit të ri për vitin akademik";</p> |
| Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendo marrëdhëniet bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj. | <p>Po. Departamenti i Matematikës për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhëniet bashkëpunimi me DAR, Fakultete dhe Departamente. FTI dhe Departamenti i Matematikës ka bërë të mundur bëjen e leksioneve të hapura nga lektorë apo përfaqësues nga institucione të rendësishme. Gjithashtu studentët nën udhëheqjen e lektorëve marrin pjesë në konkurse të ndryshme, në konferencën studentore dhe konferenca të organizuara nga FTI. Nga Bashkëpunimi I UAMD në kuadër të projekteve të Bashkimit European Erasmus+ duke bërë të mundur realizimin e shumë mobiliteteve për studentët dhe stafin akademik.</p> |
| Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucionet, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | <p>Po. Departamenti i Matematikës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me DAR për realizimin e praktikave profesionale në nivel Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti. Bazuar në misionin dhe strategjinë, UAMD ka mjaft arritje përsa i përket zhvillimit të vazhdueshëm akademik dhe institucional bazuar në politikat bashkëpunimit për stafin dhe studentët. Ka pasuruar bibliotekën me botime të shumta, ka ngritur laboratore të cilësishë së lartë të cilët jo vetëm ndihmojnë studentët, por i bëjnë ata më të astë për tregun e punës ku do të konkurojnë. UAMD u ka krijuar studentëve lehtësira dhe ofron mundësi bashkëpunimi me institucionet e tjera analoge dhe e ka pjesë të strategjisë së tij mobilitetit e stafit akademik dhe të studentëve duke dhënë mundësinë për thellimin e njohurive praktike²⁴</p> <p>Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve në UAMD përkujdeset të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi për të nxitir rritjen e marrëdhënieve me institucionet homologe dhe biznese ku</p> |

¹⁹ Marreveshjet vjetore

²⁰ Rregullorja e NJSBC



| | studentët mund të kryejnë praktikat profesionale dhe mobilitetë. Për të pasur më tepër fuqi dhe disponibilitet arsimor UAMD ka parë si rrugë të mirë bashkëpunimet me universitet e tjera homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit, si strategji e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm. | | | | | | | | |
|--|---|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Po. Njësia përgjegjëse, DM për programin e studimit ka hartuar Raport analistik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit të zyrtarizuara me institucionin. Analiza dhe raportimi është një element shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e Departmentit të atematikës prandaj stafi akademik punon vazhdimisht për hartimin e modeleve për raportimin në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe sidomos veprimtarive të lidhura me studentët. ²⁵ | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>x</td> </tr> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | x |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | x | | | | | | |

| Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
|---|---------------|----------------------|---------------------|----------------------|
| | | | | X |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË

| Standardi II.1 | |
|---|---|
| Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore | |
| Kriteret | <p>Vlerësimi</p> <p>Po. Organizimi i programit është bërë me module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) mbështetur në VKM nr.41, datë 24.01.2018 për "elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në përputhje me Udhëzimin nr 31, datë 29/12/2017. Totali i Krediteve (ECTS), 120 ECTS. Kohëzgjatja normale në vite, 2 vite, forma e studimit me kohë të plotë.</p> <p>Programi përcakton qartë të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit Master i Shkencave në Mësuesi në "Matematikë – Informatikë" të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Në planin mësimor është përcaktuar ndarja e krediteve midis kurseve dhe semestrave, ndarja e veprimtarive formuese dhe pesha e tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndarja e ngarkesës së orëve mësimore në auditor dhe ngarkesa e studimit individual duke ruajtur raportet ku 32% e ngarkesës për çdo kurs zhvillohet në auditor (jo më shumë se 50%). Gjithashtu caktohet edhe ngarkesa e temës së diplomës (12 kredite) dhe që është parashikuar që të jetë 100% studim individual nga ana e studentit.</p> <p>Ndarja e peshës së kategorive për veprimtaritë formuese është në përputhje mekërkësat ligjore për programet e studimit të ciklit të dytë (master), përkatësisht:</p> <p>A – kurse bazë – 10% ;</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>B – kurse karakterizuese – 50%;</p> <p>C- kurse ndërdisiplinore/integruese – 15% ;</p> <p>D – kurse plotësuese – 10%;</p> <p>E – veprimtaritë përbyllëse – 15% ^{26 27}</p> <p>Për të kompletuar elementët që përbëjnë strukturën e programit Master i Shkencave në Mësuesi në “Matematikë –Informatikë”, në dokumentacionin shoqëruesh gjeni edhe programin lëndor²¹ dhe formatin e miratuar të diplomës dhe suplementit.²⁹</p> |
| Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | <p>Po. Programi i studimit MSH/MI synon/ndihmon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh mbështetur në Raportin “Studimi periodik për tregun e punës pas daljes së studentëve”</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë MSH /MI përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> |
| Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përbyllëse. | <p>Po. Programi i studimit parashikon ngarkesën në kredite të përcaktuara për praktikën profesionale, me ekivalentim sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 për “elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë si dhe Udhëzim nr. 29, datë 10.09.2018, për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik.</p> |
| Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimt fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi përfshinin e mësuesve të arsimt të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit. | <p>Po. Programi i ciklit të dytë “Master Shkencor” në Mësuesi Matematike- Informatikë, që formon mësues të arsimt të mesëm të ulët dhe arsimt të mesëm të lartë është në vazhdim dhe vjen si plotësim i ciklit të parë Bachelor.</p> |
| Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psikopedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përbajtje të ngjashme. | <p>Po. Programi MSH/MI në fushën e mësuesisë organizohet me 120 kredite dhe përmban 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psikopedagogjik.</p> |
| Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimt të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimt të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministritë përgjegjëse për arsimin. | Kjo fushë nuk aplikohet për këtë program studimi pasi UAMD nuk është IALme status të veçantë. |
| Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë | Po bazuar në kurrikulen ²² e programit të studimit është lehtësish e vërtetueshme qoftë në strukturë qoftë kurset e kurrikulës që mbulon programi. |

²¹ Program lendor I MSH/MI

²² Kurrikula e Programit



| | |
|--|---|
| përbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | |
| Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Po. Për kodifikimin e programit të studimit, në prite të një unifikimi nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin, UAMD duke u bazuar në direktivat ndërkombëtare ka hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve që ofron ku për programin e studimit Master i Shkencave në "Matematike-Informatike" kodi i përcaktuar është S72MS0188 ³⁶ . |
| Kriteri 9. Programet e studimit mund të janë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjisacionin në fuqi. | Ky program studimi cshte i organizuar si një program i vetem FTI, por mbetet e hapur mundesia e një bashkepunimi me IAL te tjera te interesuara ne te njejtë fushe. Me nismen per nderkombetarizimin e universiteteve mbetet e hapur mundesia per integrimin e programit me IAL te tjera vendase dhe të huaja. |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht X Përbushet plotesisht |

| Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi (Ligji 80/2015: Neni 23, 25) | |
|--|--|
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjisacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. L. 80/2015: Neni 23, Pika 3. L. 80/2015: Neni 25, Pika 4. | <p>Po. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit MSH/MI është Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), i cili përbush detyrimet ligjore për vlerësimin e brendshëm. Nuk kemi akreditim të mëparshëm të programit.. Kjo njësi ka në strukturën e saj 3 departamente si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI) 2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK) 3. Departamenti i Matematikës (DM) <p>Përbërja e FTI²³ është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Matematikës (DM). Ky departament përbëhet në total nga 15 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë prej të cilëve 4 zotërojnë titullin akademik Profesor i Asociuar, 7 zotërojnë gradën shkencore doktor i shkencave, 1 docent, dhe të tjerët janë në vazhdim të studimeve doktorale. Gjithashtu DM angazhon gjatë vitit akademik lektorë me kohë të pjesshme që janë me tituj dhe grada.⁴¹⁴²⁴³</p> |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjisacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike etj. | <p>Po. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara sipas nenit 25, të Ligjit 80/2015 për organizimin, strukturën akademike të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, strukturën e personelit akademik të departamentit si dhe strukturën akademike Permbush detyrimin per realizimin e praktikave mësimore si dhe ka një baze te mjafshuese laboratorike per aftesimin praktik te studenteve.</p> |

²³ Personeli akademik i FTI



| | |
|--|---|
| | <p>Në strukturën e FTI aktualisht janë 6 personel ndihmës akademik²⁴ ku secili prej tyre është përgjegjës për mirëmbajtjen e një laboratori të caktuar.</p> <p>Ky personel ndihmës akademik ka përfunduar studimet në profilet e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit dhe kanë kualifikimin e duhur dhe aftësitë për të mbuluar detyrimet e tyre për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe ofrimit e mbështetjes për personelin akademik për zhvillimin e orëve mësimore apo praktikave profesionale në këto laboratore²⁵.</p> <p>Gjithashtu pjesë e FTI janë edhe 6 personel administrativ në ndihmë të progameve mësimore si pjesë e sekretarissë mësimore ku një prej tyre është dedikuar për programin Master i Shkencave në Mësuesi në "Matematike-Informatike".</p> |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | <p>Po. Departamenti i Matematikës ka përcaktuar koordinatorin²⁶ e programit MSH/MI i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit eshte Dekania e FTI, Prof.asoc.Dr. Lindita Mukli.</p> <p>Koordinatori i këtij programi studimi ka qënë pjesë e grupit të punës për hartimin e kurrikulës. Ai ndjek ecurinë e studentëve dhe trajton problematikat e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të tyre.</p> <p>Koordinatori i programit gjithashtu kujdeset për ruajtjen e cilësisë dhe disiplinës së zhvillimit të mësimit në programin e studimit. Ai lehtëson dhe koordinon mbarëvajtjen e orarit, angazhohet në zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë semestrit si edhe ndjek përputhshmërinë reale të zhvillimit të mësimit me objektivat e programit dhe syllabuset e lëndëve të programit. Koordinatori i programit në mbledhje departamentit raporton në lidhje me ecurinë e programit, aspektet pozitive, problemet si edhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.</p> |

Shkalla e përbushjes së standardit

| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotesisht |
|---------------|----------------------|---------------------|----------------------|
| | | | X |

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë

(VKM nr. 41, Dt. 24. 01. 2018: Pika 2.1,2.2,2.3,2.5,2.6)

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit. Përbërja e strukturës së programit të studimit MSH/MI është përcaktuar në akte | Po. Njësia bazë DM, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë MSH/MI, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit. Përbërja e strukturës së programit të studimit MSH/MI është përcaktuar në akte |

²⁴ Personeli ndihmës akademik

²⁵ Laboratoret

²⁶ Vendim i Koordinatorit

| | |
|---|--|
| strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | ligjore e nënligjore të VKM nr.41, datë 24.01.2018 për "elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë Organizimi i këtij programi studimi është bazuar në dy vite akademike (4 semestra) me 120 kreditë ECTS, ku çdo semestër ka 15 javë mësimore në auditor, pra 60 orë mësimore (4 orë në auditor çdo javë) dhe 1 orë mësimore është 60 minuta ⁵² |
| Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Po. Programi i studimit e përbush plotësisht këtë kriter. Plani mësimor ²⁷ , ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Përbëja e strukturës së programit të studimit dhe hartimi i syllabuseve është përcaktuar në akte ligjore e nënligjore të VKM nr.41, datë 24.01.2018 për "elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë |
| Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Po. Programi i studimit të ciklit të dytë MSH/MI disponon të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ky informacion është i pasqyruar në Rregulloren e programit të studimit ²⁸ |
| Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Po. Programi i studimit MSH/MI përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. sipas Nenit ... Syllabusi/ (Programi lëndor) të rregullores së FTI. Përbëja e strukturës së programit të studimit MSH/MI dhe hartimi i syllabuseve është përcaktuar në akte ligjore e nënligjore të VKM nr.41, datë 24.01.2018 për "elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë |
| Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Po. Si një program i cili është ende i ri, në fillim të cdo viti akademik në mbledhjet e departamentit diskutohen arritjet dhe problematikat e hasura me qëllim që nëse ka propozime për ndryshim apo sistemim të bëhet e mundur në kohën e duhur. Përsa i përket literaturës ajo është në përditësim dhe përmirësim të vazdueshëm. Ndryshimet eventuale miratohen cdo fillim viti akademik dhe arkivohet dosja e plotë. Përgjegjësi i departamentit ruan çdo fillim semestri programet lëndore për të gjithë kurset e ofruara në atë semestër për programin Master i Shkencave në Mësuesi në " Matematikë-Informatikë" |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet Përmbushet pjesërisht Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht X |

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxenit, kompetencave në përputhje me kërkosat e tregut të punës

(VKM nr. 41, Dt. 24. 01. 2018)

| Kriteret | Vlerësimi |
|----------|-----------|
|----------|-----------|

²⁷ Plani mesimor

²⁸ Rregullore e programit te studimit

| | |
|---|---|
| Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimitarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Po. Emërtimi i veprimitarive të programit të studimit MSH/MI është bërë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: VKM nr.41, datë 24.01.2018 për "elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentit të MSH/MI njohuri dhe përgatitje metodologjike të përgjithshme. Lëndët karakterizuese, lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe jepin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij. Lëndët ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup - lëndë me zgjedhje. |
| Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arrijeten e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshmë të të nxënët dhe aftësimit profesional. Lëndët janë shpërndarë në semester, në fillim lëndët bazë, pastaj lëndët formuese duke mos bërë më shumë se 25 orë në javë. Programi i studimit MSH/MI është është bërë në përputhje me akte ligjore e nënligjore të VKM nr.41, datë 24.01.2018 për "elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë | Po. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arrijeten e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshmë të të nxënët dhe aftësimit profesional. Lëndët janë shpërndarë në semester, në fillim lëndët bazë, pastaj lëndët formuese duke mos bërë më shumë se 25 orë në javë. Programi i studimit MSH/MI është është bërë në përputhje me akte ligjore e nënligjore të VKM nr.41, datë 24.01.2018 për "elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë |
| Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkomëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Po. Struktura e programit ²⁹ , lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë, është bërë në përputhje me akte ligjore e nënligjore VKM nr.41, datë 24.01.2018 për "elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Lëndët në programin e studimit MSH/MI janë organizuar me kreditë të njëjtë, pasi kohëzgjatja e secilit prej kurseve është një semestër. Emërtimi dhe syllabuset e tyre janë organizuar në mënyrë të ngjashme me programet ndërkomëtare. |
